



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



EKONOMIA DHE BUXHETI

PRILL 2008

Raporti Mujor

Prill, 2008

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 225 8437

e-mail: elami@minfin.gov.al

www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi mesatar i këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	7
7. Oferta e Parasë	8
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Sufiçitetit	12
APENDIKSI STATISTIKOR.....	13


VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Prill, 2008 arriti në 102.0 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Prill ishte 4.4 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Prill 2008 ishte 77.75 lekë për dollarë dhe 122.64 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit* shënuan kuotat 6.69 përqind për depozitat 24 mujore, 6.41 për ato 12 mujore, 5.64 për 6 mujorët dhe 5.08 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 12.92 përqind për huatë 12 mujore dhe 12.40 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 759 miliardë lekë në muajin Prill, duke shënuar një rritje prej rreth 11.1 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për vitin 3 – mujojin e parë të vitit 2008* rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 25.7 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Prill, 2008 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 9.2 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara* në Janar - Prill, 2008 arritën në rreth 87.8 miliardë lekë ose rreth 30.9 përqind e planit vjetor 2008
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 78.6 miliardë lekë ose rreth 21.3 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2008

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Prill 2007 pësoi një rënie prej 0.4 përqind krahasuar me muajin Mars dhe Shkurt, kur ky indeks shënonte përkatësisht 0.9



përqind dhe 1.0 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin -0.2 përqind, -0.1 përqind dhe 0.5 përqind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit Prill u konstatua në grupin “Ushqime dhe pije joalkolike” 0.8 përqind, rënie e cila erdhi si rrjedhojë e rënies së çmimeve të nëngrupit “Ushqime” me 0.8 përqind, si dhe rënies së çmimeve të nëngrupit “Zaravate përfshire patate” me 6.9 përqind. Pësha specifike relativisht e lartë që zë ky grup në

shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ndieshme mbi normën e inflacionit. Gjatë këtij muaji rënie, prej 0.3 përqind pësoi dhe indeksi i çmimeve të grupit “Veshje dhe këpucë”.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
2008	3.0	3.6	4.6	4.4		
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2007	2.1	4.2	4.4	4.2	3.5	3.1
2008						

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Prill arriti në 4.4 përqind duke qëndruar më lartë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2007 dhe 2008 paraqiten në tabelën 1.

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Prill 2008, arriti në 122.64 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 1.6 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Prill një euro u këmbye me 122.75 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Prill 2008, arriti në 77.75 lekë/dollarë duke shënuar




Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë Mars

një rënie prej 3.2 përqind kundrejt muajit Mars. Në fund të muajit Prill, dollari amerikan arriti nivelin 78.94 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Prill të vitit të kaluar rezultojnë se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 16.7 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 2.7 përqind. Mbledhja e lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rrjedhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.577 euro/dollarë.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë muajit Prill përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetin e politikës fiskale, efikasitetin në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrura nga Banka e Shqipërisë, rritjen e flukseve hyrëse në valutë etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Prill 2008, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.41 përqind, duke pësuar një rritje prej 0.3 përqind në krahasim me muajin Mars,




ku normat e interesit shënonin vlerën 6.11 përqind. Rritje për këtë muaj kanë pësuar depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.22 përqind, normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 0.24 përqind, si dhe normat e depozitave me afat 1 - mujor me 0.04 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Prill pësoi një rritje 0.44 pikë përqind, duke arritur në 12.92 përqind nga 11.48 përqind që ishte në muajin Mars. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësoi një rritje me 1.10 pikë përqind, krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Prill arriti në 12.40 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit




Prill 2008, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 8.12 përqind, 7.47 përqind dhe 6.29 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 , 6 dhe 3 mujor.

4. Bilanci i Pagesave




Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Mars 2008 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 25.7 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.



Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 289.3 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'08 - mars'08 rezultoi:
(i) bilanci tregtar -531.1 mln euro, (ii) shërbime neto -29.7 mln euro, (iii) të ardhura neto 30.8 mln euro, (iv) transfera neto 240.9 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Prill 2008, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 23,142.5 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2007. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 6,416.5 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 16,726 milionë lekë. Në muajin Prill sistemi bankar rezulton me një rënie prej 6,981.7



milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Mars, rënie e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 4,863.1 milionë lekë si dhe të rënies së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 2,118.6 milionë lekë.

6. Kredia për Ekonominë



Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Prill 2008 arriti në 326.2 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2007 shënoi vlerën 32.3 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 11.2 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në vitin 2007.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 72.0 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 234.7 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 36.7 përqind.

7. Oferta e Parasë


Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Prill ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Mars. Kjo ofertë arriti në rreth 759 miliardë lekë në fund të muajit Prill duke shënuar një rritje prej 1.8 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin



Dhjetor 2007. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 11.1 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rënies së depozitave pa afat në lekë me rreth 2.9 përqind, rritjes së depozitave në valutë me rreth 25.4 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 12.4 përqind dhe rënies të parasë jashtë sistemit me rreth 4.4 përqind.

Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Prill e kanë patur rritja e depozitave pa afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 0.9 miliardë lekë, rritjes së depozitave në valutë me 2.5 miliardë lekë, si dhe rritjes së depozitave me afat në lekë me rreth 1.1 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit Prill arriti në 19.2 përqind duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me muajin Mars. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Prill arriti në rreth 23.8 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.4 përqind e krahasuar me muajin Mars.

Graf - 10




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 2.1 miliardë lekë në krahasim me muajin Mars.

Graf - 11




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Prill, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 75.3 përqind të depozitave totale në valutë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Prill 2008 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 54.41 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 31.62 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 11.55 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 75.3 përqind dhe rreth 20.5 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (95.5 përqind e totalit)



Përberja e depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

krahasuar me nje muaj më parë Mars, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 4.6 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe të atyre në valutë .

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 503 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 614 miliardë lekë në muajin Prill 2008. Ata ndiqen nga sektori privat (86 miliardë), ndërmarrjet publike jofinanciare (19.8 miliardë) dhe autoritetet lokale (3.1 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 2.0 miliardë në totalin e depozitave.


Gjatë muajit Prill 2008,

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar - Prill, janë mbledhur rreth 87.8 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 78.6 miliardë lekë, që përfshijnë 67.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 10.4 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 62 % financim i brendshëm, dhe 38 % financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 30.9 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2008, ndërsa shpenzimet përbëjnë 21.3 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë



Treguesit Fiskal, Prill 2008

rreth 26.6 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 9.8 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 62.9 miliardë lekë (ose rreth 32.1 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 4.4 miliarde lekë (27.9 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 15.5 miliarde lekë (30.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 4.9 miliardë lekë (26.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 67 miliardë lekë, 19.6 miliardë lekë (29.2 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 9.2 miliardë lekë (13.7 %) për interesat, 5.7 miliardë lekë (8.5 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.2 miliardë lekë (0.4 %) për subvencione, 22.6 miliardë lekë (33.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 6.1 miliardë lekë (9.1 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 3.7 miliardë lekë (5.5 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 28.9 % (shpenzime personeli), 27.6 % (shpenzime për interesat), 20.5 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 12.6 % (subvencione), 29.8 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 20.6 % dhe 24 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 10.1% të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 9.7 %.

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Prill 2008 ishin rreth 87.8 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 82.7 miliardë, grantet 250 milionë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 4.9 miliardë

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar – Prill 2008

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	32.4
Tatimi mbi fitimin	7.3
Taksa doganore	2.8
Taksat nacionale	4.7
Akcizat	9.1
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	0

3. Financimi i Suficitit

Suficiti prej 9.2 miliardë lekë, për periudhën Janar-Prill, u mbeshtet në vlerën 9.8 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 0.6 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Prill disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 24.2 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 25.4 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 16 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 19.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 5.2 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)				Mesatar Mujor (Monthly Average)				Vjetor (Annual)				Month
	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	
Janar	0.8	0.2	0.5	0.5	0.80	0.20	0.50	0.50	3.3	1.4	2.9	3.0	January
Shkurt	0.4	0.4	0.5	1.0	0.60	0.30	0.50	0.75	1.8	1.3	2.9	3.6	February
Mars	0.0	0.1	-0.1	0.9	0.40	0.23	0.30	0.80	1.6	1.5	2.7	4.6	March
Prill	-0.3	0.6	-0.2	-0.4	0.23	0.33	0.18	0.50	1.3	2.4	1.9	4.4	April
Maj	-1.1	-0.4	-0.8		-0.04	0.18	-0.02		2.0	3.1	1.4		May
Qershor	-0.5	-1.1	-0.6		-0.12	-0.03	-0.12		2.9	2.4	2.0		June
Korik	-1.2	-0.4	-0.3		-0.27	-0.09	-0.14		1.8	3.2	2.1		July
Gusht	0.2	-0.2	1.9		-0.21	-0.10	0.11		2.3	2.8	4.2		August
Shtator	0.9	0.6	0.9		-0.09	-0.02	0.20		3.1	2.6	4.4		September
Tetor	0.4	0.1	-0.1		-0.04	-0.01	0.17		3.3	2.2	4.2		October
Nendor	0.2	0.9	0.2		-0.02	0.07	0.17		3.0	2.9	3.5		November
Dhjetor	2.2	1.8	1.3		0.10	0.22	0.27		2.0	2.5	3.1		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008				Currency
									Jan	Feb	Mar	Apr	
<i>Mesatarja e periudhes</i>													<i>Average of period</i>
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	90.43	83.39	83.90	80.32	77.75	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	123.63	122.61	123.69	124.59	122.64	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>													<i>In the end of period</i>
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	82.89	82.61	82.58	78.29	78.94	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	121.78	122.61	125.34	123.70	122.75	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me baze vjetore
Annual Interest Rates

		2008					
Ne perqindje	Dhjetor 07	Janar	Shkurt	Mars	Prill	In percent	
Fundi I periudhes	Dec	Jan	Feb	Mar	Apr	End of period	
Norma e remunerimit						Remuneration rate	
ne leke	-	4.37	4.37	4.37	4.37	In Lek	
ne usd	-	2.30	2.19	1.87	2.02	In USD	
ne euro	-	2.92	2.93	3.07	3.07	in EURO	
Norma e depozitave						Deposits rates	
12-M	6.33	6.49	6.10	6.11	6.41	12-M	
6-M	5.50	5.56	5.44	5.42	5.64	6-M	
3-M	4.85	5.08	4.80	4.84	5.08	3-M	
1-M	3.21	3.59	3.48	3.58	3.62	1-M	
Norma e huase						Lending rates	
12-M	13.55	13.36	11.78	11.48	12.92	12-M	
6-M	13.85	15.53	14.29	13.50	12.40	6-M	
Norma e letrave me vlere						Securities rates	
Bobo thesari 1/						Treasury bills 1/	
3-M	6.48	6.20	6.26	6.25	6.29	3-M	
6-M	7.51	7.30	7.29	7.36	7.47	6-M	
12-M	8.41	8.14	8.00	8.02	8.12	12-M	

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2008
 Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)		ne milion leke (in million leks)			
Nr.	E M E R T I M I	Mars Mar	Prill Apr	ITEM	No.
	TOTALI TE ARDHURAVE	63,566	87,807	TOTAL REVENUE	
I.	Ndihma	41	250	Grants	I.
II.	Te ardhura tatimore	60,462	82,618	Tax Revenue	II.
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	46,867	62,853	From tax offices and customs	II.1
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	24,021	32,423	V. A. T	1
2	Tatimi mbi Fitimin	6,052	7,305	Profit Tax	2
3	Akcizat	6,518	9,070	Excise Tax	3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	4,817	6,563	Personal Income Tax	4
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	3,400	4,656	National Taxes and others	5
6	Taksa Doganore	2,059	2,835	Custom Duties	6
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	2,422	4,345	Revenues from Local Gov.	II.2
1	Taksa Lokale	1,677	3,160	Local Taxes	1
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	745	1,185	Small Business Tax	2
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur	11,173	15,420	Social ins	II.3
1	Sigurimi Shoqeror	9,973	13,776	Social Insurance	1
2	Sigurimi Shendetsor	1,201	1,644	Health insurance	2
III.	Te ardhura Jotatimore	3,063	4,939	Nontax Revenue	III.
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	Profit transfer from BOA	1
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	2,878	4,355	Income of budgetary institutions	2
4	Te tjera	185	584	Other/not allocated	4
	TOTALI I SHPENZIMEVE	53,214	78,466	TOTAL EXPENDITURE	
I.	Shpenzime Korrente	48,032	67,306	Current Expenditures	I.
I.1	Personeli	14,172	19,631	Personnel expenditures	I.1
1	Paga	11,730	16,307	Wages	1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	2,442	3,324	Social insurance contributions	2
3	Politikat e reja pagash			Of which; Contingency	3
I.2	Interesat	6,926	9,190	Interest	I.2
1	Te Brendshme	6,578	8,714	Domestic	1
2	Te Huaja	348	476	Foreign	2
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	3,703	5,744	Operational & Maintenance	I.3
I.4	Subvencionet	207	287	Subsidies	I.4
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera	16,640	22,642	Social insurance outlays	I.5
1	Sigurime Shoqerore	14,400	19,554	Social insurance	1
2	Sigurime Shendetsore	2,240	3,088	Health insurance	2
I.7	Shpenzime per Buxhetin Lokal	3,776	6,105	Local Budget	I.7
I.8	Shpenzime te tjera	2,608	3,707	Other expenditures	I.8
1	Pagesa e Papunesise	193	260	Unemployment insurance benefits	1
2	Ndihma Ekonomike	2415	3,448	Social assistance	2
3	Kompensim per ish te perndjekurit politike			Compensation for ex political prisoners	3
I.9	Kompensim ne vlere i pronareve			Property Compensation	I.9
II.	Fondi Rezerve			Reserve fund/contingency	II.
III.	Shpenzime Kapitale	5,182	10,262	Capital expenditures	III.
1	Financimi Brendshem	4,345	5,882	Domestically financing	1
2	Financimi Huaj	837	4,380	Foreign financed	2
IV	Rindertimi I Gerdecit		898		
	DEFICITI	10,352	9,341	Overall Deficit	
	FINANCIMI DEFICITIT	-10,352	-9,341	Deficit Financing	
	Brendshem	-10,561	-9,877	Domestic	
	Te ardhura nga privatizimi	121	198	Privatization receipts	
	Hua-marrje e brendeshme	5,450	5,100	Domestic Borrowing	
	Te tjera	-16,132	-15,175	Other	
	I Huaj	209	536	Foreign	
	Hua afatgjate(e marre)	910	1,070	Long-term Loan(Drawings)	
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	-178	35	Chang. of stat. Account*	
	Ripagesat	-523	-569	Repayments	
	KAPITUJT KRYESORE			Main indicators	
	Financimi i Brendshem i Deficitit			Domestically financed deficit	
	Deficiti Pergjithshem			Overall Balance	
	Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend.			Soc.& health insur.contr.-outlays	

* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2008

Expenditures by central institutions during the year 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Mars Mar	Prill Apr	Ministry or Institution
Totali	53,214	78,466	Total
Presidencia	33	44	President
Kuvendi	198	266	Parliament
Keshilli i Ministrave	66	100	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	288	375	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	574	891	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,219	8,657	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Sistemi i regjistrimit te pasurise se paluajtshme	0		Immovable Property Registration
Ministria e Financave	1,034	1,509	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	6,237	8,825	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	274	435	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	4,713	6,778	Ministry of Health
Ministria e Drejtesise	670	971	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	528	713	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	2,600	3,572	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	3,167	4,364	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ I Shtetit	232	315	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	101	132	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	26	44	General Directorate of Archive
Drejtoria e Rezerves se Shtetit	0	0	Directorate of State Reserves
Akademia e Shkencave	12	20	Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	53	71	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	16,344	22,381	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	209	344	Ministry of Environment, Foristry & Water Administration
Prokuroria e Pergjithshme	200	278	State Prosecutor
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	250	348	Office for the Administration of the Judiciary Budget
Gjykata Kushtetuese	18	26	Constitutional Court
Agjensia Telegrafike Shqiptare	36	37	Albanian Press Agency
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	0	0	General Customs Department
Drejtoria e Pergjithshme e Standarteve	0	0	General Department of Standardizations
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	17	33	General Tax Directorate
Shpenzime per sherbimin e borxhit	6,926	9,190	Dept Service
Instituti i Statistikes	39	51	Statistics Institute
Komisioni i Letrave me Vlere	8	10	Securities Commission
Shkolla e Magjistratures	11	15	School of the Magistrature
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	119	215	Rural Development Program
Qendra Kombetare Kinematografike	8	40	National Movies Center
Instituti i integrimit te perndjekurve	7	11	Institute of integration of the ex political prisoners
Inspektoriat i keshillit te larte te drejtesise	16	22	Inspection of the high Council of Justice
Avokati i popullit	20	31	Ombudsman
Komisioni i Sherbimit Civil	8	11	Commission of civil service
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	23	31	Central Committee for Elections
Entet Lokale "Granti"	3,776	6,105	Local Entities "Grant"
Inspektoriat i Larte Kontr. Deklar te Pronave	12	21	High Inspectoriate for Declaration of Properties & Assets
Autoriteti i Konkurences	10	18	Competition Authority
Ministria e Integrimit	24	33	Ministry of Integration
Komiteti Shteteror i Kthimit dhe Kompesimit te Pronave	0	33	State Commission for the Restitution & Compensation of Properties
Ajentet tatimor jo-buxhetore	19	71	Tax agents not-budgetary
Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit	0		
Te tjera	87	1,062	Others

Tab - 6 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL PER VITIN 2008
EXPENDITURES BY FUNCTIONS YEAR 2008

Te dhena progresive (Progressive Data) *ne milion leke (in million leks)*

Kodi	Funksionet	Mars Mar	Prill Apr	Functions	Code
	TOTAL	48,925	78,466	TOTAL	
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	14,416	17,329	General Public Services	01
02	Mbrojtja	1,840	2,511	Defense	02
03	Rendi dhe Siguria Publike	2,760	3,860	Public Order and Safety	03
04	Ceshtjet Ekonomike	3,390	10,562	Economic affairs	04
05	Mbrojtja e Mjedisit	18	29	Environmental protection	05
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	1,231	2,065	Housing and community amenities	06
07	Shendetesia	4,760	6,816	Health	07
08	Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	552	858	Recreation, culture and religion	08
09	Arsimi	6,589	9,400	Education	09
10	Mbrojtja Sociale	17,658	24,138	Social protection	10
11	Rindertimi I gerdecit	17,658	898	Social protection	11

*Perfshin dhe shpenzimet per interesa

Tab - 7 Tabela e investimeve 2008
Table of investments 2008

Te dhena progresive (Progressive Data) *ne milion leke(in million leks)*

	Mars Mar	Prill Apr	
Financim i brendshem	4,345	5,882	Domestic financing
<i>Ne %</i>	83.86%	57.32%	<i>In %</i>
Financim i huaj	837	4,380	Foreign financing
<i>Ne %</i>	16.14%	42.68%	<i>In %</i>
Totali	5,182	10,262	Total
<i>Ne %</i>	100.00%	100.00%	<i>In %</i>

Tab - 8

TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE
REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE
*Te dhena progresive (Progressive Data)**ne milion leke(in million leks)*

	Mars Mar	Prill April	
Takse doganore	2,566	2,835	Customs Duties
TVSH	13,301	22,515	V.A.T
Akcize	3,821	5,645	Excises
Te tjera	2	4	Others
TOTALI I DOGANAVE	19,691	30,999	Total from customs office

TE ARDHURAT TATIMORE NGA ZYRAT E TATIMEVE DHE INSTITUCIONET BUXHETORE
TAX REVENUES FROM TAX OFFICE AND OTHER INSTITUTIONS

TVSH	6,388	9,908	V.A.T
Akciza	1,514	3,425	Excises
Tatimi mbi fitimin	5,361	7,305	Profit Tax
Tatimi mbi te ardhurat personale	2,309	6,563	Personal income tax
Takse nacionale	3,295	4,021	National taxes
Lojrat e fatit dhe kazinote	361	631	Tax on Gamble & Casino
TOTALI I TATIMEVE	19,228	31,855	Total from tax office
TOTALI	38,919	62,853	Total

*Burimi : Ministria e Financave**Source : Ministry of Finance*

Tab - 9 TE ARDHURAT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK 2008
 Revenues by economic classification 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke(in million leks)

Nr.	E M E R T I M I	Mars Mar	Prill April	ITEM	No.
	Totali i te Ardhurave	63,566	87,807	Total REVENUE	
A.	BUXHETI QENDROR	62,817	86,946	Central budget	A.
I.	Ndihma	41	250	Grants	I.
II	Te ardhura nga Sigurimet Shoqerore	10,424	14,559		II
III.	Te ardhura tatimore	48,851	66,601	Tax revenues	III.
1	Tatim fitimi, te ardhurash	6,797	8,490	Profit, income tax	1
1.1	Tatim fitimi	6,052	7,305	Profit Tax	1.1
1.2	Tatim mbi biznesin e vogel	745	1,185	Small business tax	1.2
2.	Tatim mbi te ardhura personale	4,817	6,563	Personal income tax	2.
3.	Tatim mbi mallrat dhe sherb. e brendshme	34,116	47,225	Goods & services taxes	3.
3.1	TVSH	24,021	32,423	V.A.T & Turnover tax	3.1
3.2	Akciza	6,518	9,070	Excises	3.2
3.3	Taksa e rregjistrimit te automjeteve	165	222	Tax on vehicles registration	3.3
3.4	Taksa nacionale	2,338	3,169	National taxes	3.4
3.5	Taksa lokale	1,074	2,340	Local Taxes	3.5
4.	Tatime mbi tregtine dhe trans.nderkomb.	2,065	2,839	Trade & international transport taxes	4.
4.1	Taksa doganore	2,059	2,835	Customs duties	4.1
4.2	Taksa nacionale	5	4	National taxes	4.2
5.	Te tjera	1,056	1,483	Others	5.
5.1	Taksa nacionale	1,056	1,483	National taxes	5.1
5.2	Taksa lokale	0	0	Local Taxes	5.2
IV	Te ardhura jotatimore	3,501	5,536	Nontax Revenue	IV
1.	Te ardhura nga nd/jet dhe pronesia	207	613	Entrepreneurial and Property Income	1.
1.1	Transferim fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	Profit transfer from BOA	1.1
1.2	Vepimt. Ekonom. e sektorit buxhetor	28	37	Income of budgetary institutions	1.2
1.3	Dividentet	19	19	Dividends	1.3
1.4	Interesa	38	82	Interests	1.4
1.5	Te tjera	122	476	Others	1.5
2.	Sherbime administ. dhe te ardhura jo-indust.	2,878	4,332	Administrative services and non-indus receipts	2.
2.1	Nacionale	438	597	National	2.1
2.2	Lokale	438	597	Local	2.2
2.3	Jo-industriale dhe incidentale (sekondare)	2,002	3,138	Non-industrial and incidental	2.3
3.	Gjoba dhe sekuestri	409	583	Penalties	3.
4.	Te ardhura kapitale	6	8	Capital Revenues	4.
B.	Sigurime Shoqerore	749	861	Social insurance	B.
1	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	669	738	Contribution of social insurance	1
2	Kontributi i ISKSH	42	55	Contribution of the institution of health caring	2
3	Te tjera	38	68	Others	3

Tab - 10

DEFICITI DHE FINANCIMI PER 2008

The Deficit and Its Financing for 2008

*Te dhena progresive (Progressive Data)**Ne milion leke (In million Leks)*

	Mars Mar	Prill April	
Totali i te Ardhurave	63,566	87,807	Total Revenues
Totali i Shpenzimeve	53,214	78,466	Total Expenditures
Deficiti	10,352	9,341	Cash-Balance
Financimi i deficitit	-10,352	-9,341	Financing
1. I BRENDSEHEM	-10,561	-9,877	Domestic
a. Bono thesari	-4,420	-4,220	Treasury bills
b. Eurobono		0	
c. Kapitalizimi I BKT	0	-1,000	
d. Obligacione	9,870	10,320	Bonds
e. Ndryshimi i gjendjes se arkës	-13,858	-14,650	Chang.of stat. account
Depozitat e qev. ne Banken e Shqip.	-13,118	-13,580	Deposit of Government in B.O.A
Depoz. e Sigurimit Shoq. & Shend.	-740	-1,070	Deposit of Social & Health Ins.
f. Mjete ne ruajtje	37	32	Non-budget revenues
g. Te ardhura nga privatizimi	121	198	Privatization receipts
h. Te tjera detyrime	-2,310	-557	Others
2.I JASHEM	209	536	Foreign
a. Hua afatgjate	387	501	Long-term Loan
-Marre	910	1,070	Drawings
-Shlyer (Ripagesat)	523	569	Repayments
b. Ndryshimi i gjendjes se arkës	-178	35	Chang.of stat. account

Tab - 11

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Ne milion Euro

In millions Euro

	3M I - 07	3M I - 08	
Llogaria korentë	-176.6	-289.3	Current Account.
Bilanci tregetar	-442.7	-531.3	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	182.3	205.2	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-625.1	-736.5	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i sherbimeve	-27.6	-29.7	Trade Balance.
Sherbimet Kredi	265.1	295.8	Services Credit
Sherbimet Debi	-292.7	-325.5	Services Debt
Bilanci i te ardhurave	53.3	30.8	Balance of Incomes
Te ardhurat Kredi	62.0	43.2	Income Credit
Te ardhurat Debi	-8.7	-12.4	Income Debt
Bilanci i transfertave	240.4	240.9	Balance of Transfers
Transferta private	223.8	235.0	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	16.6	6.0	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	26.9	13.0	Capital Account
Llogaria financiare	151.8	205.0	Financial Account
Investime direkte	91.4	124.7	Direct Investment
Investime portofoli	18.5	1.4	Portfolio Investment
Kapitale te tjera	39.1	81.9	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	12.3	45.6	Net errors and omissions
Bilanci i pergjithshem	14.5	-25.7	Overall Balance
Rezervat	-14.5	25.7	Reserve Assets
Perdor kred & huash nga FMN	2.8	-2.9	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : BSH

Source : Bank of Albania

Tab - 12 MJETET VALUTORE NETO
Net Foreign Assets

Ne milione leke Fundi i periudhes	2007	2008				Millions of leke End of Period
		Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	
Mjetet valutore neto	170,987.2	170,629.1	174,014.1	166,689.3	164,570.7	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidenteve	186,401.6	185,951.6	189,496.2	181,402.7	179,827.6	Claims on non-residents
Ari monetar dhe sdr	163.3	1,065.3	927.1	903.9	1,215.2	Monetary gold and SDR
Monedha dhe kartemonedha ne valute	5.1	5.7	6.1	5.1	15.7	Foreign currency holdings
Depozita	45,773.8	51,084.1	47,762.8	52,176.2	52,746.4	Deposits
Letra me vlere te jorezidenteve	132,843.0	126,427.9	132,787.1	120,965.1	118,255.8	Securities
Llogari te tjera	7,616.5	7,368.7	8,013.2	7,352.5	7,594.6	Other accounts
Minus: Detyrime ndaj jorezidenteve	15,414.5	15,322.5	15,482.2	14,713.4	15,257.0	Minus: Liabilities to non-residents
Depozita	7,150.5	7,152.1	7,152.1	7,151.1	7,323.8	Deposits
Hua	1,186.4	1,194.2	1,211.4	1,182.9	1,177.1	Loans
Llogari te tjera	7,077.6	6,976.2	7,118.7	6,379.4	6,756.1	Other accounts
Mjetet e brendshme	60,112.5	55,527.5	52,353.7	49,800.7	51,759.3	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore	57,457.0	54,342.8	51,168.1	46,882.5	46,214.0	Net Claims on Central Government
Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore	78,268.5	73,053.0	65,226.2	64,816.2	64,740.7	Claims on Central Government
Letra me vlere	72,892.2	72,686.7	64,859.9	64,418.0	64,342.0	Securities
Hua	-	-	-	-	-	Loans
Llogari te tjera	5,376.3	366.3	366.3	398.2	398.7	Other accounts
Minus: Detyrime ndaj qeverise qendrore	20,811.4	18,710.2	14,058.0	17,933.6	18,526.6	Minus: Due to Central Government
Depozita	20,775.7	18,692.0	14,041.2	17,914.2	18,504.7	Deposits
Hua	-	-	-	-	-	Loans
Llogari te tjera	35.7	18.2	16.8	19.4	21.9	Other accounts
Pretendime ndaj korporatave te tjera depozituese	1,604.3	96.1	98.1	1,833.2	4,424.1	Claims on other depository corporations
Depozita	-	-	-	-	-	Deposits
Hua	1,603.5	95.4	97.5	1,832.6	4,423.5	Loans
Llogari te tjera	0.8	0.7	0.6	0.6	0.6	Other accounts
Pretendime ndaj korporatave te tjera financiare	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave te tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektoreve te tjere rezidente	1,051.1	1,088.6	1,087.4	1,084.9	1,121.1	Claims on other resident sectors

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 13 KREDIA PER EKONOMINE
Credit to Economy

Ne milion leke Fundi I periudhes	2007	2008				Million of leks End of Period
		Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	
Totali I kredise	293,869.3	295,947.7	308,984.6	316,291.1	326,255.2	Total Credit
Kredia per qeverine lokale	-	-	-	-	-	Credits to local Government
Ne leke	-	-	-	-	-	in lek
Ne valute	-	-	-	-	-	in Foreignn Currency
Kredia per korporatat jofinanciare publike	3,923.0	4,152.3	4,325.2	4,450.2	5,974.6	Credits to Public Non-financial Corporations
Ne leke	-	0.1	1.5	1.7	1.6	in lek
Ne valute	3,923.0	4,152.2	4,323.7	4,448.4	5,973.1	in Foreignn Currency
Kredia per korporatat jofinanciare private	182,050.7	181,538.8	189,874.7	195,404.9	200,084.1	Credits to other Non-financial Corporations
Ne leke	35,708.4	35,585.7	36,107.2	37,694.3	38,999.7	in lek
Ne valute	146,342.2	145,953.1	153,767.4	157,710.6	161,084.4	in Foreignn Currency
Kredia per korporatat e tjera financiare	97.4	137.7	206.5	188.8	352.9	Credits to Other Financial Corporations
Ne leke	70.2	120.8	185.2	185.6	230.1	in lek
Ne valute	27.2	16.9	21.2	3.2	122.8	in Foreignn Currency
Pretendime per sektore te tjere rezidente	107,798.2	110,118.9	114,578.2	116,247.3	119,843.5	Claims to other Resident Sectors
Ne leke	49,059.4	49,583.6	50,207.5	51,132.7	52,275.6	in lek
Ne valute	58,738.8	60,535.3	64,370.7	65,114.6	67,567.9	in Foreignn Currency

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 14

OFERTA E PARASE

Money Supply

Mujor-Monthly

Ne milion leke Fundi I periudhes	2007	2008				Millions of LEK End of Period
		Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	
Baza monetare	228,230.9	217,220.3	217,694.5	213,577.7	215,966.6	Base Money
Ndryshimi vjetor ne %	4.9	2.6	2.7	0.1	2.1	Y/Y change in %
Paraja jashte korporatave depozituese	154,956.2	146,947.6	147,128.6	146,812.7	146,158.6	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor ne %	-5.1	-5.5	-4.8	-4.3	-4.4	Y/Y change in %
Rezervat e bankave	67,035.6	63,383.7	64,849.7	59,507.3	63,329.5	Bank's Reserves
Ndryshimi vjetor ne %	35.8	24.7	24.7	10.0	20.7	Y/Y change in %
Depozita	602,653.7	611,934.0	614,702.4	607,701.3	613,275.5	Deposits
Ndryshimi vjetor ne %	19.8	19.1	17.8	15.7	15.5	Y/Y change in %
Agregati M1	242,676.0	225,720.4	221,229.4	215,205.5	215,615.9	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor ne %	0.1	-2.2	-2.2	-4.5	-3.7	Y/Y change in %
Agregati M2	506,137.5	501,853.5	500,814.3	498,249.6	500,192.6	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor ne %	6.0	5.7	5.4	4.6	4.7	Y/Y change in %
Agregati M3	757,609.9	758,881.6	761,831.1	754,513.9	759,434.1	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor ne %	13.7	13.4	12.6	11.2	11.1	Y/Y change in %
Burimet e bazes monetare						Bonetary Base sources
Mjetet e huaja neto	170,987.2	170,629.1	17,401.1	166,689.3	164,570.7	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	60,112.5	55,527.4	52,353.8	49,800.9	51,750.2	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverise qendrore neto	57,457.0	54,342.9	51,168.3	46,882.7	46,214.1	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave te tjera depozituese	1,604.3	96.0	98.1	1,833.2	4,424.1	Claims on other depository corporatons
Te tjera neto	-481.4	5,367.6	2,609.9	1,768.5	1,451.4	Remaining items net

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 15
DEPOZITAT
 Deposits

Ne milione leke Fundi i periudhes	2007	2008				Millions of Leks End of Period
		Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	
Depozitat pa afat ne leke te rezidenteve	91,608	83,403	77,948	72,398	73,381	Demand Deposits in Lek
Autoritetet lokale	644	686	660	874	848	Local authorities
Ndermarrjet jofinanciare publike	11,486	7,622	7,763	8,576	8,474	Nonfinancial Public Entreprises
Institutet financiare	557	1,206	867	740	930	Financial Institutes
Sektori privat	36,519	34,629	29,440	22,207	23,200	Private Sector
Individet	42,402	39,260	39,217	40,002	39,929	Households
Depozitat me afat ne leke te rezidenteve	256,407	268,879	271,478	275,417	276,513	Time Deposits in Lek
Autoritetet lokale	206	220	173	113	1	Local authorities
Ndermarrjet jofinanciare publike	2,462	3,220	2,773	2,824	3,307	Nonfinancial Public Entreprises
Institutet financiare	286	263	253	288	264	Financial Institutes
Sektori privat	6,326	7,329	7,024	8,970	8,963	Private Sector
Individet	247,128	257,847	261,254	263,221	263,979	Households
Depozitat ne valute te rezidenteve	258,218	263,468	267,544	262,193	264,765	Time Deposits in Foreign Currency
Autoritetet lokale	1,875	2,649	2,745	2,419	2,218	Local authorities
Ndermarrjet jofinanciare publike	8,168	7,903	7,061	7,833	8,099	Nonfinancial Public Entreprises
Institutet financiare	1,563	1,003	1,190	895	879	Financial Institutes
Sektori privat	56,096	55,356	54,551	53,967	54,258	Private Sector
Individet	190,515	196,558	201,997	197,080	199,311	Households
Depozitat gjithsej	606,233	615,750	616,969	610,007	614,658	Total of Deposits
Autoritetet lokale	2,724	3,555	3,578	3,405	3,067	Local authorities
Ndermarrjet jofinanciare publike	22,116	18,745	17,597	19,233	19,879	Nonfinancial Public Entreprises
Institutet financiare	2,406	2,472	2,310	1,923	2,073	Financial Institutes
Sektori privat	98,941	97,314	91,015	85,144	86,421	Private Sector
Individet	480,045	493,664	502,468	500,303	503,218	Households

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 16

BILANCI I PERMBLEDHUR I BSH
Consolidated BoA Balance sheet

Ne milion leke Fundi I periudhes	2005	2006	2007	2008				Millions of Lek End of period
				Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	
AKTIVET	224,655	255,481	260,127	257,579	260,219	253,286	254,519	ASSET
Mjete te huaja	153,329	174,587	182,525	181,685	189,496	181,403	179,828	Foreign assets
Ari	708	797	923	1,016	5,539	5,079	4,742	Gold
Depozita lek FMN	8,431	7,867	7,031	7,935	7,800	7,765	8,074	Deposits with the IMF
Depozita ne bankat e huaja	10,175	38,157	40,976	45,803	42,225	47,099	48,006	Deposits with foreign banks
Letra me vlere	133,464	117,404	124,096	117,242	123,658	112,183	109,521	Securities
Investime te mbajtura per tregetim		9,636	8,747	9,186	9,129	8,782	8,735	Securities held for trading investments
Mjete te tjera te huaja	551	726	752	503	1,145	495	750	Other foreign assets
Mjete vendase	71,326	80,894	77,602	75,894	70,723	71,883	74,691	Domestic assets
Ari dhe metale te çmuara	50	53	63	69	2,714	2,481	2,307	Other gold and precious metals
Kredi tranzite	207	139	95	95	98	83	82	Transit credits
Hua dhene bankave	0	8,904	1,509	0	0	1,750	4,342	Loans to the Banks
Hua per qeverine	0	0	0	0	0	0	0	Loans to the Government
Investime ne letra me vlere	68,546	67,575	72,432	72,234	64,378	63,927	63,842	Investments in securities
Mjete te tjera ne leke	2,523	4,223	3,503	3,496	3,533	3,642	4,118	Other domestic assets
DETYRIMET	224,655	255,481	260,127	257,579	260,219	253,286	254,519	LIABILITIES
Detyrime te huaja	17,464	16,688	15,380	15,290	15,453	14,686	15,227	Foreign liabilities
Detyrime ndaj FMN-se	16,145	15,256	13,946	13,766	13,666	13,499	13,805	Due to the IMF
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	1,319	1,246	1,183	1,194	1,215	1,187	1,179	Due to non-resident fin. Institutions
Detyrime te tjera ne valute	0	186	251	330	572	0	243	Other foreign liabilities
Detyrime vendase	205,978	238,783	243,456	238,173	236,655	234,973	236,967	Domestic liabilities
Para ne qarkullim	153,550	168,234	161,162	153,425	152,825	154,051	152,568	Currency in Circulation
Detyrimet ndaj bankave rezidente	45,182	53,575	67,051	71,926	69,374	62,616	65,549	Due to domestic banks
Detyrime ndaj qeverise	6,356	15,944	14,313	11,595	13,694	17,566	18,156	Due to Government
Te ardhura per tu shperndare	129	76	3	3	3	0	0	Distributable Incomes
Detyrime te tjera ne leke	761	954	927	1,224	759	740	694	Other domestic liabilities
Fondi i vet dhe rezervat	1,213	10	1,291	4,116	8,111	3,627	2,325	Statutory fund and reserves
Fondi themelor	750	750	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	Statutory fund and reserves
Rezerva ligjore	3,750	3,750	5,181	5,181	5,181	5,181	5,181	Legal reserve
Rezerva e rivleresimit	-11,469	-15,856	-22,759	-21,224	-19,665	-24,297	-26,556	Revaluation reserve
Rezerva e rivleresimit te mjeteve fikse		2,660	1,755	1,755	1,755	1,745	1,742	
Rezerva te tjera	8,182	8,706	14,614	14,614	15,806	15,210	15,747	Other reserve
Fitimi i pashperndare	0	0	...	1,290	2,534	3,288	3,711	Retained earnings

Burimi : BSH

Source : Bank of Albania